



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:099835

Datë: 31.10.2023

Numri i dokumentit: 04855551

PKR.nr.70/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për krime të rënda, me Kryetaren e trupit gjykues Violeta Husaj Rugova, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Besa Dervishaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarit Sh.I.nga f. P., K. Gj., për vepër penale, “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267 par.2 lidhur me nenin 275 par.1 nën par. 1.8 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për krime të rënda PP/I.nr.40/2023 të datës 24.07.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur në prezencë të Prokurorit të shtetit Ersan Qavolli, të akuzuarit Sh.I.dhe mbrojtësit të tij sipas detyrës zyrtare av. Egzon Berljajolli nga Peja, me datë 30.10.2023 mori dhe shpalli, si dhe me datë 31.10.2023 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

SH.I.nga babai S. dhe nënës Z. e gjinisë S., i lindur me datë në Gj., ku dhe banon në fshatin P. K- Gj., i pa martuar, ka të kryer fakultetin juridik, i gjendjes së dobët ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr., Shqiptar Shtetas i Republikës Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Më datën 10.01.2023 rreth orës 20:50 min, në Qendrën Korrektuese në D., K. I. pavijoni nr., krahu ..dhoma . pa autorizim, shpërndan substanca të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë dhe atë narkotikun e llojit Marihuanë me sasi prej gram, në atë mënyrë që, i pandehuri Sh. nga dhoma ../. ku është duke e vuajtur dënimin, pasi siguron narkotikun e lartcekur, e vendos në trenerkë dhe së bashku me trenerkën e sipërme me ngjyrë të kuqe e hedh në korridor, në drejtim të dhomës ../. ku më pas hetohet nga

oficerët korrektues, të cilët e marrin trenkën dhe gjatë kontrollës në xhepin e majtë gjejnë një qese me ngjyrë të zezë me narkotikun e lartcekur, të cilën e sekuestrojnë.

-Me çka ka kryer veprën penale, “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267 par.2 lidhur me nenin 275 par.1 nën par. 1.8 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e neneve 7, 17, 21 par. 2, 38, 39, 40, 42,43, 69, 70,71, 72 të KPRK-së, neni 267 par.2 lidhur me nenin 275 par.1 nën par. 1.8 të KPRK-së, e lidhur me nenin 364 të KPPRK-së të akuzuarin e:

G J Y K O N

Për veprën penale si në dispozitivin e cekur si me lart, i caktohet:

-Dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti që do të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe

-Dënim me gjobë në shumë prej 150€ (njëqind e pesëdhjetë euro), që do të ekzekutohet më së largu në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Në qoftë se i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë në afat të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burg, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 (njëzet) euro të gjobës.

Të akuzuarit i konfiskohet substanca narkotike e llojit Marihuanë me sasi prej gra e cila gjendet në zingjirin e ruajtjes sipas rastit policor .-.....-.-.....-.-.-.-. dhe pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit e njëjta do të shkatërrohet.

I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20€ (njëzet euro), si dhe në emër të kompozimit të viktimave të krimit shumën prej 50€ (pesëdhjetë euro). Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për krime të rënda, ka ngrit aktakuzë PP/I.nr.40/2023 të datës 24.07.2023, ndaj të akuzuarit Sh.I nga f. P., K. Gj., për veprën penale, “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267 par.2 lidhur me nenin 275 par.1 nën par. 1.8 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 30.10.2023. Pas leximit të aktakuzës së cekur më lartë dhe njoftimit me të drejtat e tij, gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe të drejtat e tij.

Gjykata ka udhëzuar të akuzuarin për rendësin dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe i akuzuari Sh.I.pas konsultimit me mbrojtësin e tij ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, e pranon vullnetarisht pa presion dhe ndikim nga askush, është penduar dhe nuk ka me ndodh përsëri kjo vepër.

Gjykata ka dëgjuar edhe mendimin e prokurorit dhe mbrojtësit lidhur me pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë, për shkak se i njëjti ka mbështetje në shkresat e lëndës dhe konsideroi se është bërë konform dispozitave ligjore.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. Egzon Berlajolli ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë, dhe i njëjti pranimin e fajësisë e ka bërë vullnetarisht, dhe te keni parasysh se i njëjti është në vuajtje të dënimit.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës konform nenit 248 të KPPRK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 242 par.2 dhe par. 6 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjykata erdhi në përfundim se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, marrë parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: E-maili i datës 10.07.2023, fotografit e trenerkës, raporti i oficerit A. R. nr. K.I. i datës 12.01.2023, raporti iniciues disiplinor i datës 10.01.2023, forma për raportimin e incidentit e datës 10.01.2023, raporti informues nga Policia e Kosovës, Njësi i Trafikimit me narkotik në P. me dt. 14.02.2023 me nr. ref:./-./.../...., raporti i ekspertimit nr. .../....-..../...-... i datës 31.01.2023, raporti i ekspertimit nr. .../....-..../...-... i datës 30.01.2023, fotografit e narkotikut dhe shkresa e datës 12.01.2023, procesverbali mbi marrjen e deklaratës së dëshmitarit B. G. në prokurori me dt.23.06.2023 dhe në stacion policor në P. me dt.03.03.2023.

Lidhur me rrethanat për dënimin palët kanë deklaruar se nuk duan seancë të posaçme meqë janë të gatshëm të deklarohen menjëherë.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se lidhur me rrethanat për dënimin deklaroi, gjykatës i propozoi që si rrethana lehtësuese të merret për bazë pranimi i fajësisë nga ana e tij, ndërsa si rrethanë rënduese të merret për bazë e kaluara e tij kriminale.

Mbrojtësi i të akuzuarit lidhur me rrethanat për dënimin ka deklaruar se nga rrethanat lehtësuese të merret parasysh pranimi i fajit, është penduar, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla, dhe sasia e substancës narkotike është shumë e vogël.

I akuzuari Shkumbim Ibrahimimi ka deklaruar se e përkrah fjalën e mbrojtësit, dhe gjykata të ketë parasysh edhe gjendjen ekonomike, dhe mbetem pranë deklarimeve të cekura me lart.

Duke vendosur llojin dhe lartësinë e dënimit konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin e dënimit.

Nga rrethanat lehtësuese gjeti se e kanë pranuar fajësinë qysh në fillim gjendjen e dobët ekonomike.

Vendimi mbi dënimin

Nga rrethanat rënduese për të akuzuarin e lartcekur gjykata gjeti se i njëjti është i dënuar me aktgjykime të Gjykatës Themelore në Gj. P.nr.262/2021 të dt.07.10.2021 për vepër penale posedim i paautorizuar të narkotikve substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të KPRKsë, P.nr.713/2021 të 14.02.2022 për vepër penale të vjedhjes nga neni 315 par. 1 nën par. 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së (i njëjti është dënuar në bazë të aktgjykimeve të tjera por që për gjykatën nuk është e njohur nëse janë të plotfuqishme). Në bazë të këtyre aktgjykimeve të cekura është në vuajtje të dënimit dhe përkundër kësaj sërish brenda Institucionit Korrektues kryen vepër penale.

Marrë parasysh rrethanat e cekura më lartë gjykata bazuar në dispozitën e nenit 71 dhe 72 ka vlerësuar si rrethanë posaçërisht lehtësuese pranimin e fajësisë në shqyrtim fillestarë, pendimin e tij dhe premtimin para gjykatës se nuk do të përsëris vepra penale, andaj gjykata ka shqiptuar dënimin nën minimumin e paraparë ligjorë, edhe pse i dënuar më parë është hera e parë që ka kryer vepër penale brenda institucionit korrektues.

Gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi pasi që është bindur dënimet kumulative të shqiptuara janë ë në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPRK-së.

Konform nenit 267 par.5 dhe 275 par. 2 të KPRK-së konfiskohet substanca narkotike e llojit Marihuanë me sasi prej gra e cila gjendet në zingjirin e ruajtjes sipas rastit policor .-.....-.-.....-.-.-. dhe pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimit e njëjta do të shkatërrohet, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit nenin 450 të KPRK-së, i obligoi të akuzuarin në paguarjen e paushallit gjyqësor, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit i obligoi të akuzuarin që të paguaj shumën e cekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2023:099835
Datë: 31.10.2023
Numri i dokumentit: 04855551

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 364 të KPPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA,
2023:099835, 31.10.2023**

Kryetarja e trupit gjykues

Violeta Husaj Rugova

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykatë.